



MARRËVESHJE DHE PROTOKOL EKZEKUTIV MBI ZBRITJEN E TARIFAVE PËR STUDIME

Lidhur mes:

- ✓ Kolegjit BIZNESI, me seli ligjore në Prishtinë, rruga Motrat Qiriazi nr.18, i përfaqësuar nga dekani Prof. Dr. Shyqeri Kabashi.

dhe

- ✓ Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës, me seli ligjore në lagjen Kalabria, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
Tel & Fax Tel. 038/240-864 (ext.276) www.spdk-rks.org ; sindikata@dogana-ks.org

Të cilët pajtohen si vijon:

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshje është arritja e pajtueshmërisë për zbritjen e tarifave vjetore për studime në arsimin e lartë për anëtarët e Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës dhe familjarët e tyre.

Kjo marrëveshje nuk do të aplikohet për tarifa të tjera të cilat nuk konsiderohen si tarifa vjetore për studime.

Neni 2

Sindikata e Pavarur e Doganave të Kosovës duhet t'ia dorëzojë Administratës së Kolegjit BIZNESI, listën e të interesuarve për të studiuar.

Lista e kandidatëve për studimet Bachelor për vitin akademik 2020/2021 duhet të dorëzohet deri më 1 nëntor 2020, ndërsa lista e kandidatëve për studimet Master për vitin akademik 2020/2021, duhet të dorëzohet deri më 30 nëntor 2020.

Listat e dorëzuara nga Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës (SPDK) duhet të përmbajnë: numrin e protokollit, emrin dhe mbiemrin e zyrtarit si dhe datën e vendin e lindjes. Në fund të dokumentit, Sindikata e Pavarur e Doganave të Kosovës, duhet të deklarojë shprehimisht që personat, emrat e të cilëve janë të përfshirë në listat e dorëzuara, janë anëtarë të SPDK-së apo familjarë të tyre.

Neni 3

Kolegji BIZNESI obligohet që, pas marrjes së listave nga ana e Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës, të mos kërkojë dokumente shtesë lidhur me pozitën zyrtare të kandidatëve por vetëm dokumentet e nevojshme ligjore për regjistrim.

Anëtarët e Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës do të gëzojnë një zbritje prej 30 %, të shumës vjetore të tarifave universitare të aplikuara për studimet Bachelor dhe Master.

Neni 4

Ndërsa familjarët e anëtarëve të Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës do të gëzojnë zbritje prej 20 %, të shumës vjetore të tarifave universitare të aplikuara për studimet Bachelor dhe Master.

Për sqarim të dispozitave të kësaj marrëveshje, familjarë konsiderohen: babai, nëna, motra, vëllai, bashkëshortja dhe fëmijët e anëtarëve të Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës.

Neni 5

Familjarët e anëtarëve të Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës, do të jenë përfitues të kësaj marrëveshje pavarësisht faktit nëse anëtari i Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës, do të regjistrohet apo jo në Kolegjin BIZNESI.

Në rast se anëtari i Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës, ka bërë kërkesë për regjistrim në bazë të listave të dorëzuara nga Sindikata e Pavarur e Doganave të Kosovës, atëherë familjari duhet të dëshmojë lidhjen familjare me zyrtarin në fjalë nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve përkatëse të gjendjes civile (certifikatë lindjeje ose martesë).

Në rast se vetë anëtari i Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës nuk ka bërë kërkesë për regjistrim, atëherë familjari duhet të pajisjet paraprakisht me një vërtetim mbi anëtarësinë e zyrtarit doganor në Sindikatën e Pavarur të Doganave të Kosovës, të vulosur nga Sindikata e Pavarur e Doganave të Kosovës, si dhe të dëshmojë lidhjen familjare me zyrtarin në fjalë nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve përkatës të gjendjes civile (certifikatë lindjeje ose martesë).

Neni 6

Administrata e Kolegjit BIZNESI, pas pranimit të aplikimit për regjistrim nga ana e zyrtarit të Doganës së Kosovës ose të familjarëve të tij, do të nxjerrë një vendim mbi reduktimin tarifor. Ky vendim do të përmbajë numrin e protokollit, tarifën vjetore të paraparë për atë drejtim studimi, përqindjen e zbritjes së aplikuar si edhe shumën totale për t'u paguar, e cila mund të paguhet edhe me këste mujore.

Mundësia e pagesës me këste mujore nuk do të paragjykojë, në asnjë mënyrë, zbritjen e aplikuar në bazë të kësaj marrëveshje.

Neni 7

Kolegji BIZNESI angazhohet që të krijojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme administrative mbi mbarëvajtjen e obligimeve të kësaj marrëveshje, si dhe të caktojë një referent i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e zhvillimeve të marrëdhënies kontraktuale dhe ekzekutive, me Sindikatën e Pavarur të Doganës së Kosovës.

Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës angazhohet që të informojë anëtarët e saj, mbi mundësinë e parashikuar në këtë Marrëveshje si dhe të caktojë një referent i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e zhvillimeve të marrëdhënies kontraktuale dhe ekzekutive me Kolegjin BIZNESI.

Neni 8

Sindikata e Pavarur e Doganave të Kosovës do të angazhohet, që studentëve të Kolegjit BIZNESI t'ju mundësohet puna praktike në Doganën e Kosovës. Procedura dhe forma e aplikimit do të caktohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Doganës së Kosovës.

Sindikata e Pavarur e Doganave të Kosovës pajtohet që t'i ofrojë mbështetje me kuadro profesioniste ose ekspertë të fushës së sindikatës dhe doganës, të cilët sipas nevojës mund të angazhohen për të ligjësuar në Kolegjin BIZNESI, me pagesë sipas një marrëveshje paraprake në mes dy institucioneve.

Neni 9

Në bazë të kësaj marrëveshje, anëtarët e Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës dhe familjarët e tyre, do të gëzojnë zbritje të tarifave universitare të aplikuara për studimet Bachelor dhe Master në Kolegjin BIZNESI, deri në përfundim të studimeve të filluara në bazë të kësaj marrëveshje.

Marrëveshja mund të shkëputet nga secila palë me paralajmërim paraprak me shkrim prej 60 ditësh. Zgjidhja e marrëveshjes nuk do të ketë asnjë efekt, as retroaktiv, mbi privilegjin e arritur si edhe mbi vendimin administrativ të parashikuar nga neni 6 i kësaj Marrëveshje.

Në rast të zgjidhjes së marrëveshjes, anëtarët e Sindikatës së Pavarur të Doganave të Kosovës apo familjarët e tyre, do të vazhdojnë të gëzojnë zbritjet e aplikuara deri në përfundimin e studimeve.

Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me aplikimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, palët bien dakort që të njëjtat t'i zgjidhin me mirëbesim përmes një organi negociues të përbërë nga katër anëtarë: dy nga Sindikata e Pavarur e Doganave të Kosovës dhe dy nga Kolegji BIZNESI. Vetëm pas dështimit të gjetjes së një zgjidhjeje të përbashkët palët bien dakort që kompetenca t'i kalojë për shqyrtim gjyqësor civil Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 10

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e të dy institucioneve.

Për Sindikatën e Pavarur të Doganës së Kosovës:

A blue ink signature is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text "SINDIKATA E PAVARUR E DOGANAVE TË KOSOVËS" around the perimeter and a central emblem.

Për Kolegjin BIZNESI:

A blue ink signature is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text "KOLEGJI - COLLEGE" at the top, "KB" in the center, and "PRISHTINE 2004" at the bottom, with "BIZNESI" written below the stamp.

Prishtinë, më 07/12/2020